



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CN.nr.101/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi, kryetar, Beshir Islami dhe Milena Gjeriq, anëtarë, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit: B. E. Sh.A., me seli në P., Sheshi ..., kundër debitorëve: N.P.T., "...", me seli në M., të cilin e përfaqëson R. B., R. B.i, S. B., të dy nga M., dhe H. Xh. nga V., sipas propozimit të kreditorit për përmbartim, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 07.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike - përmbartimore të kreditorit: B. E. Sh.A., me seli në P., Sheshi ..., kundër debitorëve: N.P.T. "...", me seli në M., të cilin e përfaqëson R. B., R. B., S. B., të dy nga M., dhe H. Xh. nga V., me kompetencë lëndore është Gjykata Themelore Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin CP.nr.313/2013 të datës 04.11.2022, ka vendosur: I. Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas propozimit të kreditorit B. E. SH.A., P., për lëndën E.nr..., kundër debitorëve: N.P.T., "...", R. B., S. B., të dy nga M. dhe H. Xh. nga V., lidhur me pagesën e borxhit në shumën prej ... €, në bazë të dokumentit të besueshëm Marrëveshje për kredi me nr.... MI, të datës.... II. Pasi që ky aktvendim të merr formë të prerë, lënda i dërgohet Gjykatës Komerciale, për procedurë të mëtejme.

Gjykata Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin KPPP.nr. 1959/23 të datës 09.02.2024 ka vendosur: I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë, për të vendosur në çështjen përmbartimore në mes të kreditorit B. E. Sh.A., me seli në P., kundër debitorëve: N.P.T., "...", me seli në M., të cilin e përfaqëson R. B., R. B., S. B., të dy nga M., dhe H. Xh. nga V. II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Në bazë të nenit 25 paragraf 2 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatat, Ligji nr.06/L-054 i datës 23.11.2018, konfliktin lidhur me kompetencën midis gjykatave të llojit të ndryshëm e zgjidhë Gjykata Supreme e Kosovës. Në këtë rast Gjykata e Supreme e Kosovës, si gjykatë më e lartë dhe e përbashkët për gjykatat në konflikt ka kompetencë lidhur me zgjidhjen e konfliktit të kompetencës, ndërsa në bazë të nenit 15 paragraf 3, të LPK-së, përcaktohet se: “ Zgjidhjen e konfliktit për kompetencë territoriale dhe zgjidhjen e konfliktit për kompetencë e cakton trupi gjykues prej tre gjykatësve ”.

Në këtë rast kemi të bëjmë me çështjen përmbartimore midis kreditorit: Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, i cili ka ushtruar propozim, për caktimin e përmbartimit, kundër debitorëve: N.P.T., “...”, me seli në M., R. B., S. B., të dy nga M., dhe H. Xh. nga V., për shkak të borxhit. Kreditori i ka propozuar gjykatës përmbartimin në pagesën e borxhit në shumën prej ... €, në bazë të dokumentit të besueshëm Marrëveshjes mbi Pengun nr.... M1, të datës

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm dhe Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i për Çështje Ekonomike, gjeti se kompetente lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, për arsye se:

Me nenin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, përcaktohet se: “ 1. Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës gjykatat dhe përmbartuesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe ”.

Me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat nr.06/L-054, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 22, datë 18 dhjetor 2018, përcaktohet se: “ Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe ” .

Me nenin 13 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.2, të Ligjit Nr. 08/L-015, për Gjykatën Komerciale, përcaktohet se: “ Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre; 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate;...”

Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike-përmbartimore në këtë fazë të procedurës është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, për faktin se palët në këtë çështje përmbartimore pasi që është lejuar përmbartimi, lënda ka qenë në gjykatën themelore dhe nuk kanë ushtruar ndonjë mjet juridik kundër vendimit për lejimin e përmbartimit, ndërsa kreditori nuk ka kërkuar që lënda të kalojë te përmbartuesi privat ashtu siç është përcaktuar me nenin 397 të LPP, andaj Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, mbi bazën e këtyre rrethanave nuk ka mundur të shpallet jokompetente në pikëpamje lëndore por është dashur të vazhdojë në trajtimin e rastit ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e LPP-së. Në rastet kur kemi të bëjmë me zbatimin e përmbartimit sipas propozimit të kreditorit në asnjë rast nuk mund të jetë kompetente Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së parë, sepse e njëjta vendos vetëm lidhur me mjetet juridike që paraqiten ndaj lejimit

të përmbarimit dhe në rastin kur palët nuk kanë paraqitur mjet juridik (prapsim apo ankesë), në të gjitha këto raste kompetente për të gjykuar janë gjykatat themelore, varësisht prej kompetencës territoriale.

Nëse ndonjëra nga palët do të paraqiste ndonjë mjet juridik në këtë çështje përmbarimore, atëherë kjo çështje përmbarimore do të ishte në kompetencë të Gjykatës Komerciale, nëse plotësohen kushtet e përcaktuar sipas Ligjit për Gjykatën Komerciale të cekur më lart, sepse Gjykata Komerciale ka kompetencë lëndore që të vendosë për të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, ashtu siç është përcaktuar me nenin 13 paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
CN.nr.101/2024 datë 07.03.2024

Kryetar i kolegjit
Rrustem Thaqi